

**QENDRA MULTIFUNKSIONALE POGRADEC SH.A
ADMINISTRATORI**

Nr. 110 . Prot.

Pogradec, më 10 . 07 .2026

SHPALLJE PUBLIKE

**THIRRJE PËR APLIKIM PËR MBËSHTETJE FINANCIARE TË
PROJEKTEVE KULTURORE, ARTISTIKE DHE SPORTIVE, TË
PAPARASHIKUAR NË BUXHETI I SHOQËRISË PËR VITIN 2026.**

Qendra Multifunksionale Pogradec Sh.a, në zbatim të Rregullores "Për financimin e projekteve kulturore, artistike dhe sportive", dhe udhëzimit përkatës, shpall thirrjen publike për dorëzimin e projekteve nga subjektet e interesuara, me qëllim përfitim të mbështetjes financiare dhe/ose përdorimit të ambienteve në administrim të Q.M.P. Sha, për zhvillimin e aktiviteteve kulturore, artistike dhe sportive në territorin e Bashkisë Pogradec.

1. QËLLIMI I THIRRJES

Kjo thirrje synon mbështetjen dhe zhvillimin e jetës kulturore, artistike dhe sportive në Bashkinë Pogradec, nëpërmjet financimit të pjesshëm ose të plotë të projekteve që kontribuojnë në promovimin e vlerave artistike, kulturore dhe sportive.

2. SUBJEKTET QË MUND TË APLIKOJNË

Kanë të drejtë të aplikojnë për këtë thirrje publike:

- Organizata jofitimprurëse që ushtrojnë aktivitet në fushën e kulturës, artit dhe sportit.
- Institucione kulturore e sportive.
- Shoqata komunitare, klube sportive dhe grupime artistike.
- Shoqëri tregtare, të regjistruara si Shoqëri me Përgjegjësi të Kufizuar (Sh.p.k.) ose Shoqëri Aksionare (Sh.a.), me objekt apo aktivitet të lidhur me fushën e kulturës, artit apo sportit.
- Persona fizikë, vendas ose të huaj.

Aplikuesit e huaj, si dhe shtetasit shqiptarë të fushës së artit dhe kulturës që kontribuojnë në promovimin e vlerave artistike, kulturore e sportive, mund të aplikojnë njësoj si subjektet vendase.

3. FORMA E MBËSHTETJES

Mbështetja ofrohet, në varësi të natyrës së projektit, në një nga këto forma:

- Në ambiente që administrohen nga Q.M.P. Sha (salla shfaqjesh, ambiente ekspozitash, panairë etj.).
- Në mjete financiare, në formë mbështetjeje/financimi të pjesshëm ose të plotë, brenda fondit total të miratuar në buxheti i shoqërisë për vitin buxhetor 2026, duke zbritur fondet e rishpërndara.

4. DOKUMENTACIONI QË DUHET TË DORËZOHET

Çdo subjekt aplikues duhet të dorëzojë pranë Q.M.P. Sha dosjen e plotë me dokumentacionin si më poshtë:

1. Kërkesë për përfitim financiar, e protokolluar në Q.M.P. Sha.
2. Formularin e aplikimit.
3. Projektin artistik - kulturor, të ndërtuar sipas formatit të përcaktuar.
4. Ekstrakti i shoqërisë ose Vendimi i Gjykatës, Statuti i Shoqatës/Shoqërisë, Akti i Themelimit, NIPT — fotokopje e statutit dhe e aktit të themelimit (për shoqata, shpk dhe sha).
5. Vërtetim që subjekti nuk ndodhet në proces likuidimi apo nuk është likuiduar.
6. Numri i llogarisë bankare (IBAN).
7. Preventivi total, i detajuar me të gjithë zërat, ku të jenë shënuar edhe donatorët përkatës (nëse ka).
8. Preventivi pjesor, për zërat konkretë që kërkohen nga Q.M.P. Sha.
9. Deklaratë mbi autorësinë e projektit, nëse projekti është individual.
10. Në rast bashkëpunimesh mes disa subjekteve, përcaktimi i qartë i rolit të secilit pjesëmarrës.
11. Fotokopje e kartës së identitetit ose pasaportës së aplikantit.
12. CV dhe/ose dëshmi e aktivitetit artistik/sportiv të mëparshëm.

Shënim: Kur kërkesa paraqitet nga një individ (person fizik), dosja duhet të përfshijë gjithashtu biografi personale, CV dhe përshkrimin e projektit përkatës.

Shënim: Për shoqata, Sh.p.k. dhe Sh.a., dokumentacioni ligjor i personalitetit juridik (ekstrakt, statut, akt themelimi, NIPT) është i detyrueshëm dhe duhet të jetë i vlefshëm/i përditësuar në momentin e aplikimit.

5. KRITERET E VLERËSIMIT TË PROJEKTEVE

- Kontributi në zhvillimin e jetës kulturore, artistike ose sportive.
- Ndikimi i qartë komunitar/social.
- Cilësia dhe qëndrueshmëria e projektit.
- Planin financiar i qartë dhe burimet e bashkë-financimit (kur zbatohet).
- Përputhshmëria me strategjitë dhe prioritetet e Bashkisë Pogradec.

6. AFATI DHE MËNYRA E DORËZIMIT

Dosjet duhet të dorëzohen pranë zyrës së protokollit të Qendrës Multifunkionale Pogradec Sh.a, në adresën: [Qendra Multifunkionale Pogradec Sh.a, Kati II, Pallati i Kulturës "Lasgush Poradeci", Pogradec], brenda datës [26.07.2026], ora [14:00].

Aplikimet e plotësuara (me të gjithë dokumentet mbështetëse) duhet të dorëzohen **në 1 (Një) kopje të shtypura dhe një koje elektronike (CD apo USB)**, të vendosura në një zarf të vulosur mbi të cilin është shkruar referenca e thirrjes publike, përmes postës zyrtare apo personalisht, gjatë ditëve të punës (e hëne – e premte), nga ora 09:00 deri ora 15:00.

Dosjet e dorëzuara jashtë afatit ose me dokumentacion të paplotë nuk do të merren në shqyrtim, përveç rasteve kur subjektit i kërkohet plotësim brenda një afati të arsyeshëm nga Drejtoria e Qendrës Kulturore "Lasgush Poradeci".

Për informacion shtesë ose sqarime mbi procedurën e aplikimit, subjektet e interesuara mund të kontaktojnë në adresa e email: qmp2025@hotmail.com

7. PROCEDURA E SHQYRTIMIT

Pas dorëzimit, dokumentacioni shqyrtohet fillimisht nga Drejtoria e Qendrës Kulturore "Lasgush Poradeci", e më pas kalon për shqyrtim dhe miratim/refuzim pranë Këshillit Artistiko - Kulturor, brenda një afati maksimal prej 15 (pesëmbëdhjetë) ditësh nga afati përfundimtar I dorëzimit të dokumentacionit.

Rezultatet e vlerësimit do të shpallen publikisht dhe do t'u njoftohen individualisht të gjithë aplikantëve, në zbatim të parimit të transparencës të parashikuar në nenin 4 të Rregullores.

Shënim: Aktivitetet/projektet e dorëzuara duhet të zhvillohen gjatë periudhës Gusht – Dhjetor 2026.

ADMINISTRATOR
Dorian LATIFLLARI

